

Takime dhe Biseda Pune të Kryetarit të KLSH-së gjatë Kongresit INCOSAI XXI

Z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së, zhvilloi biseda të gjata dhe takime pune me homologë të SAI-ve partnere dhe të SAI-ve të tjerë pjesëmarrës në punimet e Kongresit.



Në fokus të këtyre diskutimeve, ishte forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve ekzistuese me SAI-t partnere, me të cilët tashmë KLSH ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi, të cilat janë konkretizuar në pjesën më të madhe të tyre, por edhe zhvillimi i

marrëdhënieve të ndërsjella me SAI të tjerë të përparuar, me qëllim ngritjen profesionale dhe të kapaciteteve si dhe modernizimin e mëtejshëm të institucionit.



Z.Leskaj zhvilloi takime me z.Recai Akyel, President i TCA-së dhe me z.Krzysztof Kwiatkowski, President i NIK-ut të Polonisë.




Gjatë takimeve miqësore u theksua edhe një herë marrëdhënia e suksesshme që tashmë është vendosur ndërmjet institucioneve dhe u bisedua mbi vijueshmërinë e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në të ardhmen.

Kryetari i KLSH-së, shprehu bindjen e tij se SAI-t e Turqisë dhe Polonisë, së bashku me ACA-n e Austrisë, janë partnerët strategjikë të KLSH-së. Z.Akyel dhe z.Kwiatowski e siguruan z.Leskaj për mbështetjen e tyre maksimale në vazhdimësi, për të gjitha projektet ambicioze të KLSH-së.



Gjatë bisedës me z.Josef Moser, President i ACA-s, njëkohësisht edhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, z.Leskaj theksoi edhe një herë rëndësinë e madhe që ka për KLSH-në institucionalizimi i marrëdhënieve me ACA-n dhe angazhimi i plotë i KLSH-së për të përfituar dhe mësuar nga eksperiencia dhe tradita e këtij SAI. Z.Moser, nga ana e tij, shprehu kënaqësinë për takimin dhe e siguroi z.Leskaj se marrëveshja e bashkëpunimit e nënshkruar në korrik 2013, do të materializohet në të ardhmen e afërt me projekte konkrete, kryesisht në fushën e trajnimeve të stafit të KLSH-së.

Një takim i përzemërt u zhvillua ndërmjet z.Leskaj dhe ish-Presidentit të NIK-ut, z.Jezierski, tashmë në cilësinë e Koordinatorit për Marrëdhëniet me Jashtë, pranë NIK. Gjatë bisedës, u shkëmbyen ide dhe informacione lidhur me ecurinë e marrëdhënieve dypalëshe dhe përcaktimin e prioriteteve me interes të përbashkët.



Një takim miqësor u zhvillua edhe me z.Gene Dodaro, Auditues i Përgjithshëm i GAO-s së SHBA.

Gjatë bisedës, z.Leskaj i shprehu konsideratën e tij z.Dodaro dhe kërkesën për të dërguar pranë KLSH-së një grup pune dhe ekspertize për të parë më nga afër mundësitë e bashkëpunimit. Z.Dodaro, nga ana e tij

shprehu gatishmërinë e plotë për të mbështetur këtë iniciativë.

Kryetari i KLSH-së, zhvilloi një takim me z.Liu Jiayi, Kryetar i SAI-t të Kinës, njëkohësisht edhe Kryetari i ri i Bordit Drejtues të INTOSAI-t, ku e falenderoi fillimisht për mikpritjen dhe organizimin e këtij evenimenti dhe e uroi për detyrën si President i INCOSAI-t, si dhe me zv.Kryetarin e këtij SAI, z.Dong Dasheng. Z.Jiayi, nga ana e tij, e falenderoi z.Leskaj për përshëndetjen.



Kryetari i KLSH-së, zhvilloi takime edhe me homologë të tjetër partnerë të KLSH-së, me të cilët janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, si z.Ivan Klesic, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Kroacisë, z.Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Bosnje dhe Hercegovinës, z.Milan Dabovic, President i SAI-t të Malit të Zi, zj.Tanja Tanevska, Audituese e Përgjithshme e SAI-t të Maqedonisë, z.Naser Ademi,



zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë, etj.

Gjatë bisedave me homologët, u theksua nga palët, bashkëpunimi i suksesshëm i deritanishëm në fushat e trajnimit dhe shkëmbimit të informacionit si dhe u shpreh vullneti i përgjithshëm për t'i konkretizuar edhe më tej në të ardhmen e afërt këto marrëdhënie, duke u drejtuar edhe në fusha të tjera, si auditime të përbashkëta, etj.

Në kuadrin e përpjekjeve për zgjerimin e bashkëpunimit rajonal, Z.Leskaj zhvilloi një bisedë pune me homologun e SAI-t të Greqisë z. Ioannis Karavokiris.

Gjatë diskutimeve me homologun grek, u theksua rëndësia e konkretizimit të shkëmbimit të eksperiencave dhe informacioneve ndërmjet dy institucioneve si dhe u ra dakort për përmbylljen e marrëveshjes së bashkëpunimit, në muajin dhjetor, ku do të përcaktohen qartazi edhe fushat e bashkëpunimit të përbashkët.




Një takim i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal, u zhvillua edhe me z.Radoslav Stretenovic, President i SAI-t të Serbisë, ku u shkëmbyen ide lidhur me fushat më prioritare të bashkëpunimit dhe u dakortësua për të përmbyllur një marrëveshje bashkëpunimit në fillim të vitit të ardhshëm.

Z.Leskaj, gjatë ditës së katërt të punimeve, zhvilloi një bisedë pune me z.Magnus Lindell, zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Suedisë.

Kryetari i KLSH-së, i paraqiti z.Lindell një përmbledhje mbi zhvillimet e KLSH-së përgjatë këtyre dy viteve të fundit dhe arritjet e realizuara nëpërmjet bashkëpunimit

edhe me SAI-t Turk, Polak dhe Austriak si një bosht i rëndësishëm ku mbështeten zhvillimet e KLSH-së, por duke theksuar edhe bashëkpunimin me SAI-t homologë në rajon.



Kryetari i KLSH-së e informoi z.Lindell lidhur me përfitimin nga KLSH të projektit të binjakëzimit me fondet e IPA-s për vitin 2014 si dhe nevojën për të drejtuar vëmendjen nga auditimi i performancës, ku KLSH ka nevojë për mbështetje, ashtu si edhe në fushën e IT, duke e konsideruar këtë të fundit, si një element modernizimi të institucionit.

Nga ana e tij, z.Lindell, pasi dëgjoji me vëmendje ekspozen e z.Leskaj, shprehu interesin e tij lidhur me projektin IPA dhe Planin Strategjik të KLSH-së 2013-2017, duke siguruar z.Leskaj për mbështetjen e SAI-t suedez në drejtim të rritjes së cilësisë së metodologjisë dhe trajnimit të stafit të IT, kërkesë kjo e ardhur edhe nga z.Leskaj. Gjithashtu, u ra dakort në rëndësinë që ka përcaktimi i qartë i objektivave për t'u arritur në mënyrë që të evitohen përsëritjet dhe mbivendosjet, kështu që dhe mbështetja e dhënë të mos konsiderohet formale dhe të rezultojë sa më frytdhënëse.